



Prishtine, data: 01.07.2021

KOMISIONI I PAVARUR PER MINIERA DHE MINERALE - Ne baze te Ligjit me nr.05/L-031 te procedurës se përgjithshme Administrativë dhe Udhëzimit Administrativë me nr.001/2018 mbi Procedurat e Qarkullimit te Dokumenteve, skanimi dhe ruajtje e tyre – arkivimi elektronik, ne lidhje me aktvendimin me numër te protokollit 5126 dt. 27.12.2018 për mos pagesën e rentës ndaj: **“Erozioni” Sh.p.k** me nr.të biznesit 80272120, me adresë; Sheshi i Lirisë, Pejë, merr këtë:

AKTVENDIM


1. Dorëzimi i mëtejshme i te gjitha shkresave dhe parashtrësive për **“Erozioni” Sh.p.k** me nr.të biznesit 80272120, me adresë; Sheshi i Lirisë, Pejë, tani e tutje do te behet me afishimin e tyre ne tabelën e shpalljeve ne Komisionin e Pavarur për Miniera dhe Minerale .
2. Komunikimi nga pika I e dispozitivit konsiderohet i kryer, pas kalimit te afatit prej 10 ditëve, nga dita e afishimit te tyre ne tabelën e shpalljeve ne Komisionin e Pavarur për Miniera dhe Minerale .

Arsyetim

Ndaj **“Erozioni” Sh.p.k** me nr.të biznesit 80272120, me adresë; Sheshi i Lirisë, Pejë, KPMM ka lëshuar aktin administrativ nr. 5126 dt. 27.12.2018.

Ne tentim qe t'i dorëzohet akti administrativ përputhje me nenin 7 par. 3 te Udhëzimit Administrativë me nr.001/2018 , nga fletë kthesa e kthyer nga posta dy herë me dt.04.01.2019 dhe me dt.29.03.2021 është konstatuar se pala nuk e ka pranuar aktin administrativ. Andaj, në pajtim me nenin 7.3.13 bëhet shpalljen publike të këtij akti administrativ.

Këshilla Juridike: Kundër këtij aktvendimi nuk lejohet ankimi administrative .


 Ramiz Krasniqi
 Drejtor

Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale





Republika e Kosovës – Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale
Nezavisna Komisija za Rudnike i Minerale
Independent Commission for Mines and Minerals



KOMISIONI I PAVARUR PER MINIERA DHE MINERALE (KPMIM), - në pajtim me nenin 48 dhe 50 po ashtu lidhur me nenin 33 paragrafi 4 pika a) të Rregullores së UNMIK-ut, 2005/3 mbi Minierat dhe Minerale në Kosovë, ndaj ndërmarrjes “Erozioni” shpk aplikacioni 57, licenca 428/KPMIM/2005, nr. i biznesit 80272120 me adresë Sheshi i lirisë – Pejë, pronar Xhemajl Gashi (mob. 044136234) në procedurë administrative me datë 21/12/2018, nxjerr këtë:

**AKTVENDIMI PËR MOS PAGESË TË RENTES MINERARE
NJJOFTIM PER DESHTIM**

5176
27.12.18

1. “Erozioni” shpk me nr. i biznesit 80272120 me adresë Sheshi i lirisë – Pejë,
2. Ndërmarrja “Erozioni” shpk, sipas Licences me nr. 428/KPMIM/2005, për vitet 2005 dhe 2008 ndërmarrja ka mbet pa kryer obligimit e taniemës për shumën 4,456.50€ për lëndën minerale rërë dhe zhavorr,
3. Në pajtim me nenin 48 dhe 50 po ashtu lidhur me nenin 33 paragrafi 4 pika a) të Rregullores së UNMIK-ut, 2005/3 mbi Minierat dhe Minerale në Kosovë, ndërmarrja mbetet e detyruar që të paguaj taniemën në vlerë prej 4,456.50€ pagesa të bëhet në këtë xhirologari 1000430070005950.
4. Pala ka 15 ditë afat nga data e plotfuqishmërisë së këtij Aktvendimi që të kryejë pagesën e shumës së përcaktuar në pikën 2 dhe 3 të dispozitivit.

ARSYETIM

Ndërmarrja “Erozioni” shpk, ka poseduar Licencë të Shfrytëzimit me Nr. 428/KPMIM/2005 me afat ligjor deri me datë 07.09.2008 duke ju nënshtruar të drejtave dhe detyrimeve që dalin nga neni 33 i Rregullores së UNMIK-ut, 2005/3 për Minierat dhe Minerale në Kosovë.

Bazuar në nenin 50 paragrafi 6 të Ligjit Nr.03/L-163 për Miniera dhe Minerale KPMIM-ja është organ përgjegjës për vlerësimin dhe arkëtimin e rentave minerare. Duke u mbështetur në dispozitat materiale të nenit 33 paragrafi 4 pika a) të Rregullores së UNMIK-ut, 2005/3 mbi Minierat dhe Minerale në Kosovë, ndërmarrja ka qenë e obliguar që në Komisionin e Pavarur për Miniera dhe Minerale për çdo tremujor të sjell dëshmi me shkrim se taniema e tillë është raportuar dhe paguar në shumën dhe mënyrën e paraparë sipas pjesës VII të Rregullores 2005/3.

Ndërmarrja	Afati pageses	Periudha	Viti	Deklaruar	Interesi	Bilanci
"Erozioni"	2005-2006-2007	1234	2005-2006-2007	3,631.50		3,631.50
"Erozioni"	30.04.2009	1	2008	825.00		825.00
		totali		4,456.50		4,456.50

Ndërmarrja "Erozioni" shpk, ka poseduar Licencë të Shfrytëzimit me Nr. 428/KPMM/2005 bazuar në të dhënat e mësipërme nuk ia është përmbajtur kushteve të licence të parapara sipas Rregullores 2005/3 mbi Mnierat dhe Mineratet në Kosovë.

Në rast se ndërmarrja "Erozioni" shpk, sipas Licencës së Shfrytëzimit Nr. 428/KPMM/2005 nuk i përmbushë detyrimet e saj brenda afatit të përcaktuar në dispozitiv të këtij vendimi, KPMM do të ndërmarr masa ligjore me qëllim të ekzekutimit të këtij vendimi në përputhje me Ligjin Nr.04/L-139 të Procedurës Përmbartimore.

Duke marrë parasysh arsyet e cekura më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Ky akt administrativ hyn në fuqi ditën e miratimit nga Drejtori i KPMM-së.

Këshilla Juridike: Kundër këtij aktvendimi lejohet ankimi administrativ brenda 30 ditëve nga dita kur pala e ka marrë njoftimin për nxjerrjen e aktvendimit. Ankimi administrativ i drejtohet Komisionit Shqyrtues për Ankesa të KPMM-së.

Aktvendimi i dërgohet:

- Arkivit të KPMM-së,
- Departamentit të Financave të KPMM-së,
- Palës.



Ramiz Krasniqi

Drejtor

Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale